



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

MINISTRIA E  
ADMINISTRIMIT TË  
PUSHTETIT LOKAL

**ANALIZË PËR CILËSINË E  
RAPORTIMIT TË KOMUNAVE  
NË REALIZIMIN E DETYRAVE  
NGA PVNMSA PËR  
PERIUDHËN JANAR -  
DHJETOR 2013**

Prishtinë, mars 2014

DEPARTAMENTI PËR INTEGRIME EVROPIANE DHE KOORDINIM TË POLITIKAVE

- **Qëllimi i analizës**
- **Vlerësim i përgjithshëm i cilësisë së raportimit të Komunave**
- **Efikasiteti dhe efektiviteti i zyrtarëve komunal për integritet evropian në plotësimin e raportit për PVNMSA-në**
- **Respektimi i afateve kohore të përcaktuara nga MAPL-ja lidhur me dërgimin e raportit**
- **Transparenca e zyrtarëve komunal për integritet evropian në plotësimin e raportit me të dhëna**
- **Konkluzione**

## Qëllimi i analizës

Analiza ka për qëllim vlerësimin e cilësisë së raportimit të komunave, përkatësisht të Zyrave Komonale për Integritet Evropian në realizimin e detyrave të dala nga Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Kjo është analiza e dytë me radhë e cila është hartuar për periudhën janar – dhjetor 2013. Në këtë kontekst, analiza përfshin disa nga fushat më kryesore të cilat janë marrë si pika të referimit me qëllim të verifikimit dhe vlerësimit të tyre, si: vlerësimi i përgjithshëm i cilësisë së raportimit të komunave, efikasiteti dhe efektiviteti i zyrtarëve komunal për integritet evropian në plotësimin e raportit për PVNMSA-në, respektimi i afateve kohore të përcaktuara nga MAPL-ja lidhur me dërgimin e raportit, transparenca e zyrtarëve komunal për integritet evropian në plotësimin e raportit me të dhëna.

Është e ditur se hartimi i raporteve ndryshon si për nga qëllimi e po ashtu edhe për nga metodologjia e përdorur, mirëpo po thuajse të gjitha raportet në hapin final kërkojnë të jenë unike dhe të kenë një strukturë formale, si dhe planifikim të kujdesshëm, ku materiali dhe të dhënat e paraqitura apo të plotësuara në raport nga komunat duhet të jenë të logjikshme, konkrete dhe me një gjuhë koncize, ashtu siç është kërkuar nga MAPL-ja.

Po ashtu, duhet përmendur se procesi i planifikimit, na ndihmon të jemi të kujdesshëm dhe të arrijmë deri tek hartimi i një raporti efektiv, të lexueshëm, cilësor dhe të dobishëm për audiencën, marrë parasysh faktin se përpara vetes kemi një audiencë të synuar, si atë vendore po ashtu edhe atë ndërkombëtare. Po qe se synojmë të hartojmë një raport të mirë, patjetër se ky raport duhet të jetë i thjeshtë dhe i strukturuar, ku në të do të përfshiheshin të gjitha informatat faktike me qëllim të arritjes së rezultateve të dëshiruara dhe caqeve të cilat i kemi planifikuar.


Në këtë drejtim, ideja e përgatitjes së analizës së dytë me radhë ka rrjedhur si nevojë e domosdoshme me qëllim të identifikimit të komunave të cilat kanë përmbushur apo nuk kanë përmbushur obligimet e tyre, për matjen e nivelit të cilësisë, si dhe përmes analizës vlerësuese dhe grafikoneve të paraqitura në përqindje do të paraqesim një pasqyrë reale të punës së nivelit lokal në fushën e integriteteve evropiane.

## Vlerësim i përgjithshëm i cilësisë së raportimit të Komunave

Gjatë hartimit të Raportit vjetor për zbatimin e PVNMSA-së 2013, Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave njëkohësisht ka bërë edhe analizën dhe vlerësimin e pyetësorëve të komunave për periudhën janar – dhjetor 2013, ku si tërësi kemi identifikuar se janë shënuar rezultate të kënaqshme në çështjen e raportimit dhe plotësimit të pyetësorëve me të dhëna, mirëpo është vërejtur se ende mbetet për t'u dëshiruar në ngritjen e cilësisë së raportimit nga niveli lokal. Gjithsesi, për të pasur një cilësi më të lartë të dhënat duhet të jenë më konkrete, të sakta, të përcaktuara qartë për periudhat raportuese, si dhe të dhënat mos të jenë ofruar nga periudhat e muajve të kaluar.

Duhet theksuar se disa komuna i kanë ofruar të dhënat e përsëritura, jo të qarta, të përgjithësuara dhe ndonjëherë të mangëta. Mirëpo, MAPL ka arritur të përmbledh të dhënat e ofruara nga komunat, përkundër faktit që këto elemente kanë sjellë ngadalësimin e procesit të hartimit të Raportit vjetor për zbatimin e PVNMSA-së 2013.

Në përgjithësi, raportet janë kthyer të plotësuara në adresë të MAPL-së, megjithatë, ashtu siç e potencuam edhe më lartë, në disa fusha të raporteve kemi marrë përgjigje të konsoliduar dhe të qarta, në disa pyetje të tjera përgjigjet janë të përgjithësuara, në disa të tjera mikse, kurse ka edhe fusha që fare nuk janë plotësuar me të dhëna. Së këndejmi, në përmblylljen e fazës së vlerësimit dhe finalizimit të këtyre raporteve kemi arritur në konkludim se kjo mënyrë e dhënies së përgjigjeve nga komunat paraqet një sfidë të mëtejme në hartimin e raporteve periodike për zbatimin e PVNMSA-së, ku qëllim parësor dhe objektiv kryesor i MAPL-së është që të ofrojë të dhëna sa më të plota, të sakta dhe konkrete.



**Tab.1.Përqindja e plotësimit të raportit të PVNMSA-së nga Komunat për periudhën janar – dhjetor 2013**

Nga pasqyrimi i mësipërm shohim se komunat në një përqindje të lartë kanë plotësuar raportin me të dhëna. Komuna e Istogut dhe Mitrovicës prijnë me përqindjen maksimale të plotësimit të raportit me gjithsej 100 %, pasuar nga Komuna e Klinës dhe Dragashit me 99%, Komuna e Gjakovës, Gjilanit, Podujevës, Deçanit dhe Junikut me 98%, Komuna e Drenasit 97%, Komuna e Vushtrrisë dhe Malishevës me 96%, Shtërpçës, Hanit të Elezit dhe Obliqit 95 %, Komuna e Fushë Kosovës dhe Lipjanit nga 94%, Komuna e Ferizajt, Kaçanikut, Pejës, Prizrenit, Skenderajt dhe ZAMV-s 93%, Komuna e Kamenicës dhe Novobërdës nga 89%, Komuna e Prishtinës, Shtimes dhe Rahovecit nga 87%, Komuna e Vitisë 85%, pasuar nga Komuna e Mamushës, Klllokotit dhe Graçanicës me nga 80%, Komuna e Ranillugut 77 %.


Ndërkaq, komunat të cilat nuk kanë raportuar janë: Suhareka, Parteshi, Zveçani, Leposaviçi dhe Zubin Potoku, pra përkthyer në përqindje është 0 %.

### **Efikasiteti dhe efektiviteti i zyrtarëve komunal për integritet evropiane në plotësimin e raportit për PVNMSA-në**

Në çështjen e efikasitetit dhe efektivitetit të komunave në plotësimin e raportit me të dhëna për PVNMSA-në nga zyrtarët komunal për integritet evropiane është vërejtur se kanë ndikuar disa faktor të rëndësishëm të cilët kanë krijuar vështirësi në procesin e punës së tyre, si: posedimi i disa pozitave të punës të zyrtarëve komunal për integritet evropiane brenda komunës, mungesa e stimulimit, mungesa e koherencës në mbajtjen e takimeve dhe komunikimeve brenda komunës, mungesa e kushteve të punonjësve përfshirë hapësirat për punë dhe të qenurit adekuat me ndryshimet e teknologjisë së lartë, zgjedhjet lokale ( procesi i konstituimit të organeve të reja) si dhe shumë çështje të tjera që ndërliqhen direkt me punën e tyre. Pavarësisht kësaj, ZKIE-të kanë arritur që të tejkalojnë këto sfida me qëllim të kryerjes së detyrave të punës dhe obligimeve që u takojnë. Për sa i përket efikasitetit dhe efektivitetit të zyrtarëve komunal për integritet evropiane në plotësimin e raportit me të dhëna për PVNMSA, vlerësimi i performancës së tyre është bërë në bazë të përqindjes, si në vijim:<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Vlerësimi i përqindjes është bërë mbi bazën e ofrimit të të dhënave të komunave nga pyetësorët e plotësuar;



**Tab.2.Përqindja e efikasitetit dhe efektivitetit të Komunave në plotësimin e raportit të PVNMSA-së për periudhën janar – dhjetor 2013**

## **Respektimi i afateve kohore të përcaktuara nga MAPL-ja lidhur me dërgimin e raportit**

Me datë 3.01.2014, MAPL ka dërguar në adresë të zyrave komunale për integritet evropian pyetësin e cili përmban pyetjet të cilat janë përfshirë në Planin Komunal të Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, ndërsa raportimi të bëhet për periudhën janar - dhjetor 2013. Afati i fundit për dërgimin e pyetësorëve ka qenë data 20 janar 2014. Në këtë kontekst, Komunave ju është dhënë një afat optimal kohorë, për të plotësuar pyetësin. Gjithashtu, duke marrë parasysh këtë fakt komunat kanë pasur në dispozicion kohë të mjaftueshme për të paraqitur të dhënat e tyre.

Mirëpo, për shkak të rrethanave të krijuara në komuna si rezultat i fushatës elektorale për zgjedhjet lokale të 3 nëntorit, si dhe pas kërkesës së disa komunave që afati kohor të shtyhet edhe për disa ditë, MAPL u ka mundur komunave që së paku për 3 deri në 4 ditë të kompletojnë pyetësorët me të dhëna.

Edhe pas afateve kohore të përcaktuara nga MAPL, prej 38 komunave, vetëm 33 komuna kanë dërguar pyetësorët e plotësuar me të dhëna, ndërkaq komunat të cilat nuk kanë raportuar janë Suhareka, Parteshi, Zveçani, Leposaviçi dhe Zubin Potoku, pra përkthyer në përqindje është 0 %.

## **Transparenca e zyrtarëve komunal për integritet evropian në plotësimin e raportit me të dhëna**

Si një nga parimet kryesore të qeverisjes së mirë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të demokracisë në nivelin lokal është transparenca komunale. Rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës komunale luan edhe dhënia e informacioneve të kërkuara. Në rastin konkret, zyrtarët komunal për integritet evropian janë obliguar që të ofrojnë përgjigjet e duhura lidhur me plotësimin e raportit për PVNMSA-në. Krahas kësaj është kërkuar që të respektohet afati kohor për kthimin e pyetësorëve, dhënien e përgjigjeve të sakta dhe të plota në mënyrë që raporti të jetë i qasshëm dhe efektiv.

Lidhur me këtë çështje, pothuajse të gjitha komunat janë treguar të vëmendshme në ofrimin e të dhënave, përjashtimisht bëjnë disa komuna të cilat kanë përsëritur të dhënat në pyetësor (nga muajt e kaluar), ose kanë ofruar të dhëna jo të qarta apo të përgjithësuara në disa nga fushat ku proceset janë lëvizëse.



## Konkluzione

- Përgjithësisht janë arritur rezultate të dëshiruara në çështjen e raportimit dhe plotësimit të pyetësorëve me të dhëna nga Komunat;
- Është evidentuar se Komunat në disa fusha të raporteve kanë dhënë përgjigje të konsoliduar dhe të qarta, në disa pyetje të tjera përgjigjet janë të përgjithësuara, si dhenë disa të tjera përgjigjet mungojnë;
- Transparenca e komunave në ofrimin e të dhënave është relativisht e mirë, me përjashtim të disa komunave;
- Shumica e komunave kanë respektuar afatet kohore për dërgimin e pyetësorëve, përveç 5 komunave si: Suhareka, Parteshi, Zveçani, Leposaviçi dhe Zubin Potoku të cilat nuk e kanë bërë një gjë të tillë;